



**AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT, Prishtinë**

**NJOFTIM**

Ky njoftim publikohet me qëllim të informimit të palës **Pajazit Tolaj** i cili ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (“Agjencia”), dhe me të cilin ka qenë i porealizueshëm komunikimi përmes postës.

Agjencia, bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1, të Ligjit për Shitjen e Banesave mbi të cilat Ekziston e Drejta Banesore Ligji Nr.04/L-061 (“Ligji për Shitjen e Banesave”), ka mandat për shitjen e banesave në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore. Me Ligjin për Shitjen e Banesave rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, për të cilat ekziston e drejta banesore.

Pas shqyrtimit të dëshmimeve dhe dokumentacionit në dispozicion të bashkangjitur kërkesës së palës për privatizim të banesës me nr.6436, Bordi i Agjencisë me Vendimin **Nr.Ref.BD-74/11** vendosi si në vijim:

**Kërkesa e palës për blerjen e banesës REFUZOHET SI E PABAZUAR. Si dëshmi mbështetëse kërkesës së tij, pala e ka prezantuar Vendimin mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim të datës 15.08.2001, i cili është lëshuar në kundërshtim me nenin 6 të rregullores së UNMIK-ut 2000/60, me të cilën dispozitë ndërmarrjeve shoqërore iu është marr kompetenca ligjore për ndarjen e banesave në shfrytëzim. Rrjedhimisht pala ka dështuar që ti plotësoj kushtet për privatizim të banesës të parapara me nenin 3 paragrafi 1.6 të Ligjit për Shitjen e Banesave e lidhur me nenin 2 dhe 11 të Ligjit mbi Marrëdhënie Banesore ( Gazeta Zyrtare KSA të Kosovës Nr. 11/83 dhe 42/86)**

**Shënim i rëndësishëm:**

Pala e pa kënaqur me Vendimin e Bordit, udhëzohet që ti përdor mjetet juridike pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 30 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 04/L-034) dhe nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (Ligji nr. 04/L-033).

